

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 83 96 / 26

Nr. i fq. / Br. st. - 18 -

Data: / Datum: 26.02.2026

VUSHTRRI - VUÇITRN



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**Komuna e Vushtrrisë**  
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtrri



**Kuvendi i Komunës**

**01 Nr. PB-34/26 26.02.2026**

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË,**  
**MBAJTUR MË: 29 JANAR 2025**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e "Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën 09:20. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Behar Duraku, Berat Sadiku, Betim Grabanica, Blerina Shala, Diellza Pllana, Drita Dibrani, Edmond Hyseni, Fakte Dushi, Fatmire Cecelia, Fidan Bejta, Gentiana Rama, Gresa Muli, Hava Mlinaku, Isak Uka, Kushtrim Hyseni, Kushtrim Veseli, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli Latifi, Mensur Kastrati, Mentor Ferizi, Nasuf Aliu, Pllumb Maliqi Ramadan Parduzy, Refik Maloku, Rrahim Ajeti, Stefan Markovic, Vlerë Tahiri, Xhon Gubetini dhe Ymer Haradinaj.*

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës z. Ferit Idrizi, përfaqësuesit e MAPL-së, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, - Kryesuese e Kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezentë 31 anëtarë të kuvendit, kuorum i plotë për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

**Mentor Hasani, para kuvendit dha betimin duke u bërë anëtarë i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me të drejta të plota.**

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit**-pasi konstatoi kuorumin, ceku se materialet për të gjitha pikat e rendit të ditës janë dorëzuar sipas afateve ligjore, kërkoj nga anëtari i kuvendit z. Ramadan Parduzy, që të prononcohet para kuvendit lidhur me pozitën e tij si anëtar i kuvendi, pasi që i njëjti ka dorëzuar një dorëheqje tek kryesuesja e kuvendit, nga pozita e anëtari të kuvendit, por që më pas ai nuk ka vazhduar me plotësimin e procedurës para KKZ-së për zëvendësimin e tij. Po ashtu ajo kërkoj nga të gjithë ata anëtarë të kuvendit që pozitën e tyre bien ndesh me ligjin dhe që kanë konflikt interesi që deklarohen se cilën nga pozita do ta mbajë ashtu që të shmangët konflikti i interesit, dhe njoftoj se për të gjitha këto përgjegjësin e mban secili që identifikohet se ka vepruar në kundërshtim me ligjin.

**Ramadan Parduzy, anëtar i kuvendit**-sqaroi se ai ka dorëzuar një dorëheqje tek kryesuesja e kuvendit, për arsye se nuk i është ruajtur vendi i punës aty ku aktualisht është duke punuar, në këtë rast njoftoi se është duke e pritur një përgjigje nga Drejtoria e Arsimit dhe nga institucionet qendrore, pasi ta merr këtë përgjigje atëherë konform rrethanave do të vendos se si do të veprojë.

**Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit**-në fillim të diskutimit të saj përshëndeti drejtorët e rijnë të emëruar, duke ju dëshiruar suksese. Ajo shtoj se ekzekutivi në mandatin e kaluar, ka treguar suksese të dobët dhe si rezultat i kësaj nuk ka arritur asnjëherë të jetë përfitues i granit të performancës, prej të cilit komunitat e tjera kanë fituar qindra mijëra euro. Po ashtu raportet e auditorit kanë qenë për çdo vit e më të këqija duke spikatur dhe duke u shtuar të gjeturat. Në qeverisjen e kaluar gati çdo i dyti apo i treti vendim janë kthyer nga MAPL si të kundërligjshme dhe me të njëjtin avaz ka filluar edhe ky mandat, ku në seancën e kaluar keni anuluar disa vendime të kuvendit për shkak të shkeljeve ligjore, ku edhe këtë seancë kemi disa vendime për t'i korrigjuar. Ngjashëm ka ndodhur edhe me buxhetin, ku është ndryshuar për secilën seancë të kuvendit dhe vitin që lëmë pas ai është aprovuar jashtë afatit ligjor, sepse nuk është sjellë në kuvend në muajin shtator siç parasheh ligji. Shpresoj që në këtë mandat Kryetari i Komunës dhe ekzekutivi i tij të reflektojnë dhe të punojnë më mirë.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit**-tha se, qeveria e re komunale është duke e u marrë me probleme të vjetra që i ka lënë qeveria e kaluar në gjysmë ose nuk është marrë fare me to. Ditëve të fundit kemi mjaft shumë ankesa nga qytetarët që lidhen me qeverisjen komunale. Kjo për faktin se shumica e lagjeve në qytet dhe fshatra nuk kanë ndriçim publik, kjo si pasojë e borxheve të shumta që ka komuna ndaj kompanisë KESCO dhe KEDS. Në bazë të informatave që i posedon komuna, këtyre kompanive iu ka rreth 100.000 € borxhe. Shumë fshatra të komunës kanë mungesë të ujit të pijes si Gracë, Druar, Sfaracak, Stroc, Mihaliq, Gllavatin, Bivolak e shumë fshatra tjera. Punëtorët e NPL "Përparimi" të cilët punojnë në kushte të vështira, pagat e tyre të vogla i marrin me disa ditë vonesë, dhe për më tepër se gjatë muaj këtyre punëtorëve nuk iu është paguar trusti pensional. Kryetari i komunës dhe qeverisja e tij nuk kanë bërë pagesën e subvencioneve 6 centë për litër të qumështit për fermerët për vitet 2023,2024 dhe 2025, edhe pse këto kanë qenë të rregulluar me buxhetet e këtyre viteve, por një gjë e tillë nuk është bërë. Shumë mësimdhënës që punësohen për herë të parë ata punojnë për disa muaj pa i marrë pagat e tyre, nuk e dimë se cili është problemi po kemi ankesa të vazhdueshme nga këtë mësimdhënës. Qeveria e kaluar komunale nuk ka bërë pagesën e subvencioneve për fëmijët e porsalindur edhe pse edhe kjo çështje ka qenë e rregulluar me buxhetin e vitit 2025. Nuk keni bërë pagesën e këshillave lokalë. Prandaj për të gjitha këto mangësi dhe lëshime kërkoj që këto çështje të adresohen pasi që jemi në fillim të mandati. Ai konstatoj se të gjitha këto problem janë pasojë e keq menaxhimit dhe paafësisë së kryetari të komunës dhe qeverisë së tij.

**Berat Sadiku, anëtar i kuvendit**-pasi i përshëndeti të pranishmit, deklaroi se në këtë seancë do të ishte mirë të jetë i pranishëm edhe Kryetari i Komunës, pasi kemi disa pyetje dhe tema për t'ia adresuar atij. Tutje shtoi se, është e papranueshme sjelljet dhe praktika që janë ndërtuar që nga viti 2021, kur po peshkohen disa asamblistë nga LDK dhe LVV, kjo është kontra-produktive dhe e dëmshme për zhvillimet demokratike në Komunën e Vushtrrisë. Për të gjitha këto pasojat do t'i bartni vetë si pushtet dhe kjo do të ju hakmerret. Të gjitha këto shkarje dhe devijime të qëllimshme me ndërhyrje në propozime qoftë në KPF apo Komitet për Komunitete janë shumë të dëmshme dhe ne jemi kundër tyre. Si rezultat i këtyre devijimeve po ndodh që vetëm në seancën e kaluar patëm disa vendime që është dashur të anulohen e ngjashëm po ndodhë edhe këtë seancë, kjo po ndodh sepse nuk kemi koordinim mes qeverisë dhe kuvendit të komunës. Njëri ndër vendimet që është anuluar është edhe vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për dëshmorin Basri Beqiri, kur nëse është shikuar me kujdes del se MAPL nuk ka kërkuar që ky vendim të shfuqizohet dhe nuk e kupton se përse një vendim i tillë është sjellë për shfuqizim.

**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit**-pasi i përshëndeti të pranishmit, ngriti shqetësimin e saj lidhur me punën e edukatoreve dhe mungesës së asistentëve për nxënësit me nevoja të veçanta. Më tej kërkoi nga drejtoresha e Arsimit që ta respektoj Udhëzimin Administrativë të nxjerr nga MASHT, që të gjitha edukatorët që janë me fakultet shtetëror duhet me qenë në shkolla publike

me jep mësim në shkolla, ndërsa ato që kanë përfunduar në fakultetet privat duhet të angazhohen në çerdhe. Ky është një diskriminim që po iu bëhet edukatoreve tash e disa vite. Kjo pyetje i adresohet direkt Drejtoreshës së Arsimit. Pastaj shtoi se një fëmijë në shkollën fillore "Naim Frashri" është përjashtuar nga shkolla me vendim të drejtoreshës, me arsyetimin se bënë zhurmë në procesin mësimor (fëmija është në grupin parashkollor dhe ky fëmijë është me nevoja të veçanta), ky veprim përpos që është i papranueshëm është edhe i kundërligjshëm. Ajo paralajmëroi se këtë çështje do ta ngrit edhe në instancat tjera kompetente për të ndërmarr veprimet e nevojshme. Më tej vlerësoi se në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, u kërkuar që bëhet ndryshimi i orarit të mbledhjes së kuvendit nga ora 10:00 në ora 9:00, për të qenë prezent Kryetari i Komunës dhe kryetari përsëri nuk është prezent.

**Fidan Bejta, anëtar i kuvendit**- pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit ai uroj drejtorët që i kanë marrë pozitat e reja, duke ju dëshiruar suksese në punë! Në këtë kontekst vlerësoi se për gjitha punët e mira dhe në interes qytetarë do ta kenë përkrahjen gjithëherë, ndërsa për punë jo të mira do të jenë përherë opozitë e fuqishme. Tutje shtoi se diskutimet e anëtarëve të kuvendit nuk duhet të jenë vetëm sa për thënë diçka, sepse Vushtrria vuan nga mungesa e njerëzve me ide të mira. Ai ftoj për bashkëpunim ndërpartiak duke ofruar më të mirën për qytetar dhe lënë me një anë simbolet partiake po duke ofruar gjithsecili ekspertizën e tij për interes kolektiv pa dallime partiake e politike.

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit**- pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit ajo uroj drejtorët që i kanë marrë pozitat dhe përgjegjësitë për ti drejtuar proceset. Më tej shtoi se sipas Statutit të Komunës, kuvendi është organi më i lartë i Komunës dhe përgjegjës duhet të jemi para këtij kuvendi, por kjo si duke nuk i bënë përshtypje disa prej drejtorëve, sepse prej 14 drejtorëve sa i ka komuna, sot i kemi prezent vetëm 7 prej tyre dhe kjo tregon seriozitetin e kësaj qeverie. Pastaj vlerësoi se është akoma më gabim që kryetari i komunës nuk merr pjesë në seancat e kuvendit, sidomos në pjesën paraprake të saj kur zhvillohen diskutimet e përgjithshme për t'i dëgjuar e shqyrtuar hallet e qytetarëve. Për më tepër është obligim i kryetarit të komunës që të prezantoj para kuvendit por edhe për qytetare kabinetin e tij qeveritar.

**Betim Grabanica, anëtar i kuvendit**-ngriti çështjen e thirrjeve publike për bujqit, ku ceku se Komuna e Vushtrrisë i ka 1530 fermerë dhe për këta fermerë është marr vendim nga kuvendit që të përkrahen me thirrje publike për vitin 2023, 2024 viti 2025 mungon. Ai pyeti se vendime e kuvendit a janë legjitime në raport me Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë e Bujqësisë lidhur me thirrjet dhe mbështetjen financiare për fermerët e komunës së Vushtrrisë. Kjo për faktin se është e pa tolerueshme dhe papranueshme të mos përkrahen këta fermer kur dihet fakti se Komuna e Vushtrrisë shquhet si komunë bujqësore. Ai bëri thirrje që të zbatohen vendimet e kuvendit për sa i përket mbështetjes për bujqit e Komunës së Vushtrrisë. Në fund ai kërkoj që të gjitha pronat publike të shfrytëzohen në të mirën e përgjithshme dhe jo për individ dhe biznese të caktuara.

**Ramadan Parduzi, anëtar i kuvendit**-kërkoj nga Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, që të rritet mbështetja financiare për sportin, sidomos për klubet e hendboll F dhe Klubi i Hendbollit M, të cilat dështuan si pasoj e mungesës së mjeteve financiare nga super liga në ligen e parë.

**Mek Selaci, anëtar i kuvendit**-shtroj çështjen e emërimeve në kabinetin qeveritar ku nga 14 drejtorët sa ka Komuna e Vushtrrisë, kemi vetëm tri gra të emëruar, që në përqindje është vetëm 18%, dhe kjo pak sepse është dashur që minimum të jetë 50% kota gjinore.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit**-pyeti kryesuesen e kuvendit se kjo mbledhje e kuvendit a është duke u mbajtur në harmoni me ligjin për faktin se mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa është mbajtur vetëm dy ditë para seancës së Kuvendit.

Pas diktimeve, të anëtarëve të kuvendit, kuvendi pas votimit me 30 vota “për” aprovoj për rend dite kërkesën për rishqyrtimin e vendimit Nr.65277/25 i datës 30.12.2025 për themelimin e Komitetit për Komunitete.

**Pas shqyrtimit të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota “unanime”, aprovoi këtë:**

## R E N D D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 12 dhjetor 2025;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 30 dhjetor 2025;
3. Raporti për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, për vitin 2025;
4. Propozim-vendim për formimin e komisionit të aksionarëve në NPL. “Përparimi” në Vushtri;
5. Propozim-vendim për formimin e komisionit të aksionarëve në KRM. “Uniteti” në Vushtri;
6. Propozim-vendim për ndryshimin dhe plotësimin e tabelave buxhetore 4.1 dhe 4.2 të Buxhetit të Komunës së Vushtrrisë, për vitet 2026-2028;
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës për nismën e ndryshimit dhe plotësimit të Statutit të Komunës së Vushtrrisë;
8. Draft – Rregullore për Transparencë në Komunën e Vushtrrisë;
9. Draft – Plani i veprimit për transparencë komunale, 2026-2029;
10. Rishqyrtimi i vendimit Nr.65281/25 i datës 30.12.2025 për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënin në shfrytëzim për vitin 2026;
11. Rishqyrtimi i vendimit Nr.65277/25 i datës 30.12.2025 për themelimin e Komitetit për Komunitete.
12. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 12 dhjetor 2025;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” miratoi Procesverbalin nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 12 dhjetor 2025.**

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 30 dhjetor 2025;

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit**-diskutimi i tij u përqendrua tek procesverbali i komitetit dhe tek rekomandimet e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, konkretisht te pika e 4-të në procesverbal thuhet: *për këtë pikë të rendit të ditës KPF-ja rekomandoi: që të bëhet blerja e veturave për administratë komunale Vushtrri, ku projekti hynë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, kurse mjetet financiare merren nga projektet me bashkëfinancim me donator në Drejtorinë e Bujqësisë, shuma prej 70.000 € nga granti qeveritar, ndërsa 10.000.00 € nga të hyrat vetnake të këtij projekti.* Ai pretendon se kjo pjesë e këtij diskutimi fare nuk është diskutuar dhe nuk qenë temë e debati, por kjo është shtuar qëllimisht nga ana e procesmbajtësit apo kryesueses së kuvendit.

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së**- konfirmoj se pretendimi i parafolësit nuk është i qëndrueshëm sepse ai rekomandim është diskutuar dhe ai mund të provohet edhe përmes audioincizimit.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” miratoi Procesverbalin nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 30 dhjetor 2025.**

**3. Raporti për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, për vitin 2025;**

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit**-deklaroi se nëse i referohemi raportit për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, për vitin 2025, atëherë të krijohet përshtypja se gjithçka ka shkuar në rregull se fondet buxhetore janë shpenzuar në masën mbi 90% të tyre, ndërsa punët dhe projektet nuk janë përfunduar. Kjo argumentohet se trotuar i filluar tek fshati Sfarçak akoma nuk ka përfunduar, në ndërkohë përgjigja e komunës është se nuk kemi mjete financiare sepse ato i ka marrë përmbaruesi. Ajo vlerësoi se shumë mirë ka vepruar kryetari që e ka ndërruar Drejtorin e Bujqësisë, sepse ai drejtor që ishte mandatin që shkoj nuk ka pasur sukses, ndërsa presim që drejtori aktual të jetë më i suksesshëm, kur dihet edhe fakti se Vushtrria është vend bujqësor.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit**-tha se përveç se Drejtori i Financave është mjeshtër i kamuflimit të shifrave, ai ka filluar që edhe formatin e raporti ta zvogëloj ashtu që shifrat mos të shihen fare. Pastaj kërkoj sqarime lidhur me kodin buxhetor 13460 shërbime kontraktues tjera 4,13,497.00 € çka janë dedikuar këto mjete, kodi buxhetor 13509 pajisje tjera më pak se një mijë euro vlera 94,380.00 €, çfarë është blerë më këto mjete, kodi buxhetor 14410 vlera 897,000 € vendime gjyqësore, prej tyre kodi 13200 vlera për vendim gjyqësore 251,000 € dhe kodi vlera 580,000.00 € për vendime gjyqësore dhe cili është sqarime për këto mjete financiare. Lidhur me mjetet për pagesën e mësueseve kërkoj që kjo të sjellët në mënyrë të deshifruar saktësisht duke e përcaktuar se sa mjete i kanë takuar avokati, përmbaruesit sa shpenzime të gjykatë dhe sa i kanë takuar vet mësimdhënësit. Pastaj tek bujqësia fondi me bashkëfinancim me donator vlera 1,120.000.00 €, por nuk e dimë se cilat projekte janë realizuar përmes këtij fondi. Tutje pyetje për Drejtorin e Urbanizimit, ku thuhet se për fshatrat Mihaliq, Druar, Reznik dhe Shallcë janë ndarë 10,000.00 € për asfaltimin e rrugëve, dhe pyetja është se sa metra asfalt janë shtuar me këto mjete financiare të ndara, dhe nga sa metra janë shtruar për secilin prej këtyre fshatrave të përmendura.

**Berat Sadiku, anëtar i kuvendit**-tha se referuar raporti duhet përgëzuar Drejtorinë e Urbanizimit, ku realizimi buxheti është 99.7%, gjë që nuk ka ndodhur asnjëherë mandateve të kaluara, sepse nga 2,500.000 € kanë shkuar në suficit vetëm 6000 € por këtu ka dyshime të bazuar se si janë shpenzuar këto mjete financiare, apo janë kryer pagesat pa u përfunduar punët për projektet që kanë qenë të planifikuara, në këtë drejtim duhet pasur kujdes që gjëra të tilla të mos na ndodhin komunës sonë.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit**-referuar raporti, mund të thuhet se shpenzimet janë realizuar por projektet dhe punët nuk janë kryer dhe kjo parqet shqetësim real. Këto shqetësime ai i ka ngritur edhe në mbledhjen e komiteti, dhe përgjigja e Drejtori të Financave, ka qenë se buxheti është shpenzuar dhe projektet janë realizuar, dhe tani kanë mbetur vetëm ato projekte që janë dy dhe tri vjeçare. E vërteta natyrisht së është ndryshe për faktin se jemi dëshmitar që komuna ka dështuar të bëj pagesat e ndriçimit publik, mjete për fëmijët, ato për bujqit, nuk është përfunduar uji, rrugët, kanalizimi dhe shumë e shumë pagesa të tjera për projekte që kanë mbetur të pa përfunduara. Vërtet nëse shikohet shpenzimi i buxhetit atëherë të krijohet përshtypja se gjithçka ka shkuar për mrekulli sepse buxheti është shpenzuar por qytetarët nuk kanë përfituar sepse nuk janë kryer punët. Më tej u ndal tek furnizimi me lëndë djegëse-dru për shkolla vlera 147,811 € për vitin 2024, ndërsa për vitin 2025 207,000.00 € që i bie një dallim prej 60,000.00€, kjo si pasojë e blerjes së druve me çmim astronomik jashtëzakonisht i lartë. Tek mirëmbajtja e rrugëve lokale është ditur që kemi një planifikim të tillë sepse diku me një e diku me dy kamion është shpërndarë zhavorr për shtrim të rrugëve në këmbim të votave, dhe

pyeti se ku kanë shkuar mbi 541,000.00 € për mirëmbajtën e rrugëve lokale, duke sjell një raport të detajuar se cilat rrugë lokale janë shtruar me këto mjete. Sa i përket qirave nga 4400.00 € kemi rritjen në 26,688 € në vitin 2025. Ajo çka bënë përshtypje është fakti se qiraja tek rastet sociale 18,900 € në vitin 2024, në vitin 2025 janë vetëm 600€, a janë zvogëluar rastet sociale në Komunën e Vushtrrisë apo nuk janë paguar fare këto qira.

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-paraqiti** sqarime të hollësishme lidhur me raportin për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, për vitin 2025, duke u përgjigjur në çështjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit. Ai njoftoj se edhe përkund vështirësive financiare për shkak të vendimeve gjyqësore përmbarimore, asnjë projekt nuk është ndal, dhe edhe ato projekte që kanë mbetur në gjysmë do të përfundohen gjatë këtij fiti fiskal. Tek kategoria mallra dhe shërbime obligimet kontraktuese, që pyeti anëtari i kuvendit z.Maloku, ai sqaroi se për këto kode funksionale, do të ofroj përgjigje me shkrim për faktin se në kuadër të kësaj janë realizuar një mori projektesh që ngërthejnë në vete shumë shifra dhe shënime. Sa i përket listës së vendimeve gjyqësore përmbarimore dhe shumave financiare ai kishte raportuar edhe vitin e kaluar. Këto lista dërgohen nga Departamenti i Thesarit nga Ministria e Financave dhe janë të parapara se mjete i takojnë mësimdhënësit, sa avokatit sa janë shpenzime përmbarimore dhe shpenzimet e gjykatës, këto shënime janë publike dhe legale, dhe për qasje në këto duhet të i drejtohesh me shkrim Drejtorisë së Financave të Komunës së Vushtrrisë.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 21 vota “për” aprovoj Raportin për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, për vitin 2025.**

4. Propozim-vendim për formimin e komisionit të aksionarëve në NPL. “Përparimi” në Vushtri;

**Vlerë Tahiri, anëtare e kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të PDK-së propozoi për anëtar të komisionit të aksionarëve në NPL. “Përparimi” në Vushtri z. Mentor Ferizi.

**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të LVV-së propozoi për anëtar të komisionit të aksionarëve në NPL. “Përparimi” në Vushtri z. Edmond Hyseni.

**Drita Dibrani, anëtare e kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të LVV-së propozoi për anëtar të komisionit të aksionarëve në NPL. “Përparimi” në Vushtri z. Mek Selaci.

Pas propozimeve, kryesuesja e kuvendit në mënyrë individuale i hodhi në votim propozime-emrat për anëtarë të komisionit të aksionarëve në NPL. “Përparimi” në Vushtri,

Nga votimi rezulton me sa vijon:

Mentor Ferizi mori 22 vota “për”

Edmond Hyseni mori 18 vota “për”

Mek Selaci mori 8 vota “për”

**Lidhur me këtë pikët të rendit të ditës u vendos me sa vijon:**

1. Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve në NPL “Përparimi” SH.A në Vushtri, si në vijim:

1.1 Mentor Ferizi, anëtar i Kuvendit të Komunës;

1.2 Edmond Hyseni, anëtar i Kuvendit të Komunës.

2. Komisioni Komunal i Aksionarëve do të i ushtroj detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Ndërmarrjet Publike si dhe Statutin e NPL "Përparimi" në Vushtri.

3. Mandati i Komisionit Komunal të Aksionarëve është i njëjtë me mandatin e tanishëm të kuvendit të Komunës.

4. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

5. Propozim-vendim për formimin e komisionit të aksionarëve në KRM. "Uniteti" në Vushtri;

**Vlerë Tahiri, anëtar e kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të PDK-së propozoi për anëtar të komisionit të aksionarëve në KRM. "Uniteti" në Vushtri z. Mentor Hasani.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të LVV-së propozoi për anëtar të komisionit të aksionarëve në NPL. "Përparimi" në Vushtri znj. Drita Dibrani.

**Berat Sadiku, anëtar i kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të LDK-së propozoi për anëtar të komisionit të aksionarëve në KRM. "Uniteti" në Vushtri z. Isak Uka.

Pas propozimeve, kryesuesja e kuvendit në mënyrë individuale i hodhi në votim propozime-emrat për anëtarë të komisionit të aksionarëve në KRM. "Uniteti" në Vushtri,

Nga votimi rezulton me sa vijon:

Mentor Hasani mori 29 vota "për" 1 votë "abstenim"

Drita Dibrani mori 8 vota "për"

Isak Uka mori 19 vota "për"

**Lidhur me këtë pikët të rendit të ditës u vendos me sa vijon:**

1. Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve në KRM "Uniteti" SH.A Mitrovica në Mitrovicë, si në vijim:

1.1 Mentor Hasani, anëtar i Kuvendit të Komunës

1.2 Isak Uka, anëtar i Kuvendit të Komunës

2. Komisioni Komunal i Aksionarëve do të i ushtroj detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Ndërmarrjet Publike si dhe Statutin e NPL "Përparimi" në Vushtri.

3. Mandati i Komisionit Komunal të Aksionarëve është i njëjtë me mandatin e tanishëm të kuvendit të Komunës.

4. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

6. Propozim-vendim për ndryshimin dhe plotësimin e tabelave buxhetore 4.1 dhe 4.2 të Buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitet 2026-2028;

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-** paraqiti sqarime të hollësishme lidhur me Propozim-vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e tabelave buxhetore 4.1 dhe 4.2 të Buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitet 2026-2028, duke shtuar se në totalitet kategoritë ekonomike në shumat komunaltive nuk ndryshohet por vetëm bëhet ndryshimi dhe harmonizimi i tabelave buxhetore në kontekst të disa projekteve siç edhe janë cekur në propozim-vendim, me theks të veçantë ndërtimi i shtëpisë për të moshuarit. Pastaj sqaroi se në propozim-vendim në mënyrë tekstuale, janë prezantuar shumta e mjeteve financiare, kodet dhe drejtoritë se ku do të merren mjete për financimin e projektit <ndërtimi i shtëpisë për të moshuarit>, nga granit qeveritar dhe nga të hyrat vetanake por edhe për projekt tjera. Po ashtu ai sqaroi se ndryshimet konsistojnë edhe në një projekt të ri <blerja e një automjeti të ri, mjetet merren nga fondi me bashkëfinancim me donator, 70.000.00 € nga granti qeveritar, dhe 10.000.00 € nga të hyrat vetnake shuma totale 80.000.00 € baret në tabelën 4.2 Drejtorinë e Shërbimeve Publike>.

**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-**deklaroi se i ka krahasuar tabelat buxhetore nga buxheti i komunës që është aprovuar më datën 30.10.2025, dhe ato që tani janë sjell sot në kuvend për ndryshim dhe plotësim. Tutje shtoj se komuna nuk ka buxhet më shumë se sa është ndarë sipas qarkores buxhetor, dhe nuk mund të marrim më shumë buxhet për t'i prishur kornizat aktuale buxhetore. Secilin projekt që e keni propozuar për ndryshim e ka analizuar dhe krejt kjo është bërë me qëllim që të financohen dy apo tri projekte. Ajo njoftoj se edhe në muajin nëntor kishte deklaruar se jeni duke vepruar gabim dhe pikërisht për këtë ka ndodhur që është kthyer buxheti nga ana e ministrisë sepse nuk keni vepruar sipas afateve ligjore. Tani prapë ka mundësi që ky vendim por edhe buxheti për vitin 2026 të kthehet si paligjshëm dhe komuna jonë do të rrezikonte të futej në kolaps financiar. Pastaj shtoi se u përmend këtu rr. "Lidhja e Lezhës" por për këtë projekt nuk është paraparë fare buxhet as për vitin 2026 dhe as për vitin 2027. Më tej shtoj se nuk qëndron konstatimi se Ministria e Financave e ka detyruar komunë për iniciimin e zhvillimit të projektit <ndërtimi i shtëpisë për komunitetin e të moshuarve>, dhe vlerësoi se ministria mund të rekomandoj por as si ajo nuk mund ta detyroj komunën për ndonjë projekt. Lidhur me projektin ndërtimi i stacionit të autobusëve, kërkoj të bëhet e ditur se ku e ka caktuar komuna lokacionin për ndërtimin e këtij stacioni, e po ashtu ku dhe kur do të ndërtohet shtëpia e komuniteti për të moshuarit, e që për ne ky projekt është tepër i mirëseardhur.

**Berat Sadiku, anëtar i kuvendit-**tha se sa i përket tabelave 4.1 dhe 4.2 dhe shpjegimeve që i dha Drejtori i Financave jemi dakord. Por ajo çka nuk pajtohen është mënyra se si është bërë planifikimi i këtyre projekteve, sepse nëse i shohim projekt nga fusha e planifikimi shumica e tyre është dashur të përfundojnë maksimumi brenda afatit prej tri viteve, ndërsa ne kemi projekt siç është ndërtimi i rrugës "Bekim Berisha-Abeja" që është viti i katër që ky projekt planifikohet në buxhet dhe akoma nuk ka përfunduar, vlera 194,000.00 € e planifikuar për vitin 2026, pastaj është rr."Lumni Surdulli" vlera e planifikuar 72,000.00 €, ajo çka është shqetësues është rikonstruktimi i bulevardit "Adem Jashari" dhe shfrytëzimi i parkut të qytetit për zgjerimin e këtij sheshi dhe për këtë pyeti se si është menduar lidhja e parkut të qytetit me bulevardin "Adem Jashari". Kjo për faktin se Komuna e Vushtrrisë zyrtarisht ka 61,000.00 banorë, dhe ka vetëm një parak të vetëm dhe jemi dëshmitar se me projektin rikonstruktimi i bulevardit "Adem Jashari" e ka marr rreth 30% edhe parkun e qyteti si parka i vetëm në Vushtrri. Kjo është jashtëzakonisht e dëmshme, për faktin se ne duhet të tentojmë të kemi sa më shumë hapësira të gjelbëruara brenda hapësirave urbane dhe kjo nuk i kontribuon kësaj. Projekti rikonstruktimi i bulevardit "Adem Jashari" ka kushtuar mbi 3 milion euro, ndërsa për vitin 2026 janë planifikuar 1.7000.00 €, që është një vlerë alarmante, prandaj pyeti se si do të sigurohen këto mjete, kur dihet se Komuna e Vushtrrisë është në borxhe jashtëzakonisht të mëdha. Po ashtu shqetësues është edhe planifikimi i mjeteve për rrugët Smrkomicë, Dobërlluk, Banjësk, vlera vetë prej 40,000.00 €, ndërsa vetëm për fshatin Prelluzhë dhe Gracë janë planifikuar mbi 750,000.00 €.



**Ramadan Parduzi, anëtar i kuvendit**-tha se nuk është planifikuar asnjë mjetë financiar për rr. “Jeton Tërsten” ku ajo rrugë ka nevojë për një trotuar, por edhe disa mermetime tjera që janë shumë të nevojshme.

**Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit**-deklaroi se fakti që ne po merremi me buxhet në janar të vitit 2026, kur buxheti është dashur të përfundoj në shtator të viti 2025, kjo tregon për aftësinë e kësaj qeverie komunale për ti shtyrë proceset përpara. Pastaj pyeti Drejtorin e Financave se sa është shuma e mjeteve financiare që janë marrë për vendim gjyqësore nga investimet kapitale dhe a janë përfshirë në buxhetin e këtij viti këto mjete, nëse po në cilat projekte janë bartur mjetet, pasi që kjo është dashur të sqarohet tek tabela 4.2 kategoria investimet kapitale-shpalosja e buxhetit.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës**-duke ju adresuar qytetarëve të komunës dhe anëtarëve të kuvendit, paraqiti sqarime për anëtarë e kuvendit ku ndër të tjera deklaroi: se për të gjitha projekte fillimisht planifikohet buxheti e më pas nisin procedurat tjera për zhvillimin e tyre. Në këtë kontekst shtoj se për projektin ndërtimi i stacionit të autobusëve në njërën nga seancat e ardhshme do të vjen propozimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stacionit të autobusëve. Më tej shtjelloj se me Agjencinë e Pronave ka qenë në vizitë dhe ka diskutuar, për fillimin e procedurave për shpronësim të parcelave ku do të ndërtohet stacioni i autobusëve dhe shtëpia për të moshuarit. Lidhur me disa projekte tjera si rrugët: “Lumni Surdulli”, Rr. “Bekim Berisha-Abeja”, por edhe projekti rikonstruktimi i bulevardit “Adem Jashari, ku u përmendin disa shifra, por e vërteta është se shumë mjetet financiare i janë marrë komunës së Vushtrisë me proceduar përmbarimore vetëm në vitin 2025 na janë marrë afër 3.5 milion euro, që në substancë e ka dëmtuar komunën dhe zhvillimin e projekteve. Prandaj planifikim i buxhetit për këto projekt është bërë për faktin se operatorët ekonomik i kanë kryer punët por pagesat nuk i'u bërë. Sa i përket parkut të qytetit, ceku se sheshi i qytetit ka qenë i ndarë me një rrugë dhe ne atë rrugë e kemi mbyll, pjesa ku ka qenë shtatorja e “Adem Jasharit” në pjesën harkore nuk është prekur asgjë, në anën e majtë është zgjatur pak për shkak të parkingut nëntokësor, por mundem me matë saktësisht këtë përqindje do të dalin shumë më të vogla sepse 30% është përqindje shumë e madhe dhe nuk beson se del në realitet, por vetëm mund të flasim me hamendësime. Në pyetjen se si do të bëhet lidhja mes bulevardit “Adem Jashari, dhe parkut të qytetit, ceku se lidhja është bërë përmes shkallëve është ndërtuar edhe sheshi dhe do të vazhdohet edhe me rikonstruktimin e pjesës tjetër të sheshit të qytetit. Ai vlerësoi se më punën që është bërë në parkun e qytetit mund të thuhet se për herë të parë ai park është bërë i shfrytëzueshëm. Lidhur me rr. “Jeton Tërsten” ka kërkuar nga kompani për hartimin e projekteve që të hartoj një projekt ngjashëm sikurse në rr. “Lumni Surdulli” për rregullimin dhe zgjerimin e asaj rruge. Lidhur me trotuarin në Nedakoc, ceku se ai trotuar është dashur të përfundoj, por kanë qenë disa problem me operatorin kontraktues por shpreson se posaçërisht do të merret me këtë problematikë.

**Berat Sadiku, anëtar i kuvendit**-pyeti se kontrata për rregullimin e parkut të qytetit a është pjesë e kontratës për rikonstruktimin dhe ndërtimin e bulevardit “Adem Jashari” apo është lidhur kontratë e re. Më tej shtoj se shfrytëzimi i hapësirës së parkut për parking nëntokësor dhe ndërtimi i vetë këtij parkingu në fillim të sheshit dhe në qendër të qyteti në aspektin e planifikimit urbanë është gabim, sepse garazhet nëntokësore zakonisht bëhen në periferi të qytetit. Kjo u dëshmuar gjatë muajve të verës kur patëm fluks të bashkatdhetarëve kur kishim bllokim të rrugëve në qendër të qytetit. Sa i përket stacionit të autobusëve tha se ju përgëzoj për iniciativën, dhe sugjeroi që fillimisht të bëhet një studim i fizibilitetit për këtë projekt e më tej të vazhdohet me caktimin e lokacionit.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 20 vota “për” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim ndryshohen dhe plotësohen tabelat buxhetore 4.1 dhe 4.2 të buxhetit të Komunës së Vushtrisë për vitet 2026-2028 në kategoritë si në vijim:

1.1 Në kategorinë investime kapitale, nga këto projekte, në drejtoritë:

#### **Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim**

- Ndërtimi i kanalizimeve në Vushtri, Samadrexhë, Maxhunaj, Stanoc - shuma totale nga granti qeveritar është 120.000.00€. Nga kjo shumë barten 20.000.00€.

#### **Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural**

- Projektet në bashkëfinancim me donatorë - shuma totale e projektit është 768.796.00€. Nga kjo shumë barten 30.000.00€ nga granti qeveritar.

➤

#### **Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit**

- Ndërtimi i rr. "2 Maji" me infrastrukturë përcjellëse - shuma totale e projektit është 200.000.00€, nga kjo shumë barten 20.000.00€ nga granti qeveritar.
- Ndërtimi i rrugëve lokale në Dumnicë, Maxhunaj, Stanoc, Lumadh, Vilanc, Ropicë, Pestovë - shuma totale e projektit është 317.700.00€, nga kjo shumë barten 40.000.00€ nga granti qeveritar.
- Ndërtimi i rrugëve lokale në Gracë, Prelluzhë - shuma totale e projektit është 120.000.00€, nga kjo shumë barten 40.000.00€ nga granti qeveritar.
- Rindërtimi dhe zgjerimi i rrugëve me infrastrukturë përcjellëse (Rr."Bahri Kuqi", Smrekonicë, Dobërlukë, Maxhunaj, Sllatinë, Pasomë, Shtitaricë, Dolak, Vërnice, Nadakoc, Pestovë, Bukosh - shuma totale e projektit është 120.000.00€, nga kjo shumë barten 75.000.00€ nga granti qeveritar.
- Rindërtimi dhe zgjerimi i rr. Lidhja e Lezhës dhe infrastrukturë përcjellës - shuma totale e projektit është 20.000.00€, nga kjo shumë barten 15.000.00€ nga granti qeveritar.

#### **Drejtoria për Arsim (Arsimi Fillor)**

- Ndërtimi i shkollës fillore e SHFMU "Emin Duraku" - shuma totale e projektit është 20.000.00€, nga kjo shumë barten 10.000.00€ nga granti qeveritar.
- Ndërtimi i çerdheve (Qytet, Lumadh, Smrekonicë, Maxhunaj, Bukosh, Pestovë) - shuma totale e projektit është 20.000.00€, nga kjo shumë barten 10.000.00€ nga granti qeveritar.

- Ndërtimi i shkollës fillore SHFMU "7 Marsi" Bukosh - shuma totale e projektit është 20.000.00€, nga kjo shumë barten 10.000.00€ nga granti qeveritar.

2. Shuma totale e mjeteve të bartura nga projektet e sipërcekura është 270.000.00€, mjete financiare të cilat barten për financimin e projekteve: Rehabilitimi i rrugëve në Smrekonicë, Dobërllukë, Sllatinë, Pasomë (Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit) – 40.000.00€, si dhe projekti: Ndërtimi i shtëpisë të komunitetit për të moshuar (Shërbimet rezidenciale) – 230.000.00€.

3. Nga tabela 4.1 – kategoria e pagave, mallra dhe shërbime, komunal, subvencione, harmonizimi është bërë sipas vendimit për aprovimin e buxhetit për vitet 2026-2028.

4. Në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve projekti: Renovimi, izolimi, fasadimi, rikonstruimi i çatave dhe bodrumeve të objekteve kolektive dhe komunale shuma 2.715.335.29 €, në vitin 2026 shuma 1.357.667.65 €.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtorja për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

6. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë tabela 4.1 dhe 4.2, të cilat janë aprovuar në kuadër të vendimit për aprovimin e buxhetit të komunës për vitet 2026-2028.

7. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

7. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës për nismën e ndryshimit dhe plotësimit të Statutit të Komunës së Vushtrrisë;

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit**-pyeti se cila është arsyeja dhe cila është nevoja për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë, kur dihet fakti se statuti aktual është miratuar para 3 viteve dhe kjo është një kohë relativisht e shkurtër për të ndryshuar sërish. Kërkoj të di se si është ideuar të bëhen ndryshime para se të votohet.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës**-tha se për shkak të dinamikës dhe ndryshimi të rrethanave dhe disa ligjeve, ka lindur nevoja për ndryshimin dhe plotësimin e dokumentit kryesor Statutit të komunës. Ai njoftoi se do të ndryshohen edhe një mori e rregulloreve komunale me qëllim që ato t'i përshtaten nevojave të qytetarëve. Ai shtoi se pasi të themelohet komisioni do të filloj punën dhe do të sjellë një draft të plotësim-ndryshimit dhe më pas do të pasojnë edhe ndryshimet tjera të rregulloreve komunale.

**Lidhur me kërkesën për nismën e ndryshimit dhe plotësimit të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, kuvendi pas votimit me 30 vota "për" vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim miratohet nisma e Kryetarit të komunës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë 01Nr. 209/22, i miratuar më datë 06.09.2022.

2. Tekstin e ndryshim-plotësimeve të Statutit të komunës do ta përgatitë komisioni, i themeluar me vendim të Kuvendit të komunës.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: anëtarët e Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë.

4. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës u formua komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës, kuvendi pas votimit me 30 vota “për” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim formohet komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë në këtë përbërje:

- 1.1. Rrahim Ajeti, anëtar i Kuvendit (PDK);
- 1.2. Refik Maloku, anëtar i Kuvendit (LVV);
- 1.3. Betim Grabanica, anëtar i Kuvendit (LDK);
- 1.4. Fatime Haziri, (Zyra Ligjore e Komunës) dhe
- 1.5. Edona Pushkolli, (Zyra Ligjore e Komunës).

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, i cili ka për obligim që t'i hartojë ndryshimet statutare dhe të njëjtat duhet t'ia ofrojë Kuvendit të komunës për aprovim.

3. Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi ka për detyrë të mbajë takime, dhe në përbërjen e tij duhet të zgjedh kryesuesin e komisionit dhe procesmbajtësin, ashtu që të evidentojë ndryshim-plotësimet e dispozitave statutare dhe të përgatitë draftin <Propozim-ndryshimet e Statutit bazë të Komunës së Vushtrrisë>.

4. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

8. Draft – Rregullore për Transparencë në Komunën e Vushtrrisë;

**Lidhur me këtë pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 28 vota “për” 1 votë “kundër” aprovoj Rregulloren për Transparencë në Komunën e Vushtrrisë.**

9. Draft – Plani i veprimit për transparencë komunale 2026-2029;

**Lidhur me këtë pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 28 vota “për” 2 vota “abstenim” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim aprovohet Plani për Transparencë Komunale në Komunën e Vushtrrisë për periudhën 2026-2029.

2. Qëllimi i aprovimit të këtij plani është konsolidimi i infrastrukturës juridike me qëllim të arritjes së objektivave të transparencës të administratës të Komunës së Vushtrrisë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kuvndi i Komunës, Kryetari i Komunës dhe drejtoritë komunale në Komunën e Vushtrrisë.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Plani për Transparencë Komunale në Komunën e Vushtrrisë për periudhën 2026-2029.

5. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

10. Rishqyrtimi i vendimit Nr.65281/25 i datës 30.12.2025 për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënin në shfrytëzim për vitin 2026;

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit**-tha se kur është aprovuar rendi i ditës nuk është përmendur fare kjo pikë e rendit të ditës që lidhet me rishqyrtimin e vendimit Nr.65281/25 i datës 30.12.2025 për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënin në shfrytëzim për vitin 2026, dhe kjo mund të konstatohet edhe nga video-incizimi i seancës së kuvendit i cili mund të rishikohet. Me fjalë tjera kjo pikë e rendit të ditës fare nuk është përmendur dhe votuar dhe si tillë konsiderohet se nuk ka hi në rendin e ditës.

**Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit**-deklaroi duke arsyetuar, se kjo pikë e rendit të ditës që lidhet me rishqyrtimin e vendimit Nr.65281/25 i datës 30.12.2025 për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënin në shfrytëzim për vitin 2026, është proceduar si pikë e rregullt e rendit të ditës, dhe se e njëjta është trajtuar nga ana e Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe është rekomanduar të procedohet për shqyrtim dhe aprovim në kuvendin e komunës, dhe kësajohet është dërguar edhe materiali në kopje fizik dhe elektronike. Fakti se kjo pikë nuk u përmend fare është sepse kjo pikë është proceduar si pikë e rregullt e rendit të ditës, jo sikurse është rasti me Rishqyrtimi i vendimit Nr.65277/25 i datës 30.12.2025 për themelimin e Komitetit për Komunitete, pikë kjo e cila ka ardhur pas është mbajtur mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe ajo është dashur të votohet në formë të veçantë. Duke u nisur nga këto premisa dhe konsideron se kjo pikë duhet të shqyrtohet dhe aprovohet sepse duhet të respektohet afati ligjor 30 ditor për rishqyrtimin e saj sipas vlerësimeve të MAPL-së.

**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit**- tha se pak më herët kur e patë një pyetje një nga anëtarët e kuvendit, kryesuesja e kuvendit deklaroi se materiali në KPF ju ka ardhur me kohë dhe materiali për seancë të rregullt ju ka ardhur shumë më përpara, po ajo i rikujtoj kryesuese së kuvendit që kjo lista komplet kjo pikë ka ardhur në KPF aty për aty në tavolinë nuk ka ardhur më herët, kështu që s'ka ardhur as në emali 7 dite pune siç parashihet me ligj. Lista ka ardhur në KPF aty për aty e para, e dyta me plotësimet që kanë ardhur me numër të parcelave dallon lista e pronave mes afateve prej kur është mbajtur mbledhje e KPF-së deri tek seanca e kuvendit, kjo i bie se i kemi dy lloj të listave të pronave. Po ashtu kemi shkelje të afateve ligjore sepse MAPL-ka kërkuar respektim të afatit ligjor sepse këtu është cekur saktë që duhet brenda afatit ligjor në muajin dhjetor deri me 31 dhjetor me dalë këto prona në shfrytëzim me dal si thirrje në afat ligjor deri në përfundim të vitit kalendarik nuk ka ndodh kjo prapë i keni sjell me vonës për shkak që ju janë kthyer nga MAPL-ja me vendim dhe arsyetimin e keni të qarte të gjithë d.m.th nuk e keni pasur në KPF pjesën e parcelave kështu që është mirë me kompletuar lëndën me sjell për aprovim në kuvend për shkak se edhe ashtu jeni vonë ka kaluar afati. Prandaj kjo pikë të shtyjme edhe 2-3 jave mos ta kthej prapë MAPL-ja sepse nuk është e kompletuar, sepse tani kanë ardhur parcelat tash në këtë mbledhje.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit**- ta kemi parasysh secilin diskutim po e marr si të mirëqenë për me hedh në sipërfaqe qysh duhet vazhduar, ju lutem nuk ka ardhur me herët

sepse është pikë e rendit të ditës e cila është shqyrtuar në mbledhjen paraprake të kuvendit, mandej është kthyer në atë kohë menjëherë si është kthyer në kemi sjell në KPF, prandaj s'kemi pasur mundësi të veprojmë më herëte pa pasur përgjigje nga MAPL. Megjithatë prej KPF-së ka hy drejtpërdrejt në kuvend dhe tjetra është afati ligjor që ne nuk mundemi me tejkaluar përtej 30 ditësh. Kështu konsideroj që kjo përmes KPF-së është proceduar dhe nuk është hera e parë që kemi vepruar kështu, si rekomandim është në rend dite. Ky është një vendim që duhet të rishqyrtohet që është kthyer është diskutuar një here në kuvend është në tjetër nivel kjo kërkesë. Është diskutuar në seancën paraprak të kuvendin dhe është ardhur pak para mbledhjes së KPF-së dhe menjëherë e kemi sjell për rishqyrtim në po atë mbledhje të ashtu që mos ta lëshojmë afatin 30 ditor që është obligim për të vepruar dhe ndërmarrë veprime.

**Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit-** pyeti se të gjitha këto prona që janë në këtë listë a janë të pastra në aspektin juridik? Kjo e konteston komplet çështjen p.sh po flas për zonën kadastrale në Terllabuq ku është një padi e datës 2 mars 2022 dhe është në procedurë gjyqësore për ato parcela. Seanca e parë është mbajtur para dy javësh, dhe ato parcela krejt janë në procedurë kontestimore gjyqësore. Ato parcela sot i ke në listën që janë sjell para anëtarëve të kuvendit. Anëtarët e kuvendit nuk guxojnë me votuar ose me i dhënë në shfrytëzim parcela të cilat janë në kontest gjyqësorë.

**Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-së-** pasi i përshëndeti të pranishmit deklaroi: shpresoj që këto 4 vite kemi me kaluar mirë së bashku dhe transparent çdo gjë. Sa i përket listës se pronave kjo liste është votuar në vitin e kaluar në seancën e parë, e njëjta listë është prapë kjo listë është votuar njëherë MAPL-ja e ka kthyer vetëm me i bërë plotësimet të kolonave afatet, destinimin, sips Planit Zhvillimor Komunal janë në përputhje periudhën e këto për shkak të afatit ligjor që është kthyer prej MAPL-se, propozuesi ato vërejtjet që janë ardhur prej MAPL-së i ka plotësuar dhe i ka dorëzuar përmes KPF-se dhe janë ardhur këtu. Sa i përket kontesteve ju keni mundur kur i keni votuar herën e parë i keni pas në gjeoportali secili ku është me numër me të gjitha ato janë bërë vërejtjet, kjo është votuar njëherë , nuk me është dhënë mundësia të hulumtoj dhe me shikuar edhe për shkak të afatit kohor dhe për shkak që është votuar njëherë, në këtë pikë kemi vetëm plotësime , plotësime MAPL-ja çfarë ka kërkuar ajo nuk ka thënë të largohen kjo pronë ose të lihet në listë kjo pronë, vetëm të plotësohen ato vërejtje çfarë i ka dhen ato janë plotësuar, kur të vijmë në hapin e dytë që e ceket që është kontest këto lista vetëm janë të propozuara kur të vjen koha për shpallje atëherë ne duhet me pas kujdes secilën prone veç e veç kur t'i qesim në shpallje në ankand publik ofertat ato që shkojnë përmes ligjit atëherë ne i ndalim edhe pse janë votuar ne jemi të vetëdijshëm që nuk e shtyjmë procesin me përpara mirëpo kjo është një listë e votuar, vetëm a janë plotësuar kriteret të cilat i ka kërkuar MAPL-ja , ku të gjitha në periudhën e fundit , për çka përdoret afati kohor, është fat që këto kanë kërkuar për Plan Zhvillimor besoj që këtë vit shumë shpejt edhe Plani Zhvillimor është në proces e sipër të përfundimit, dhe dhënia e këtyre pronave në shfrytëzim dhe investimet do të bëhen konform këtij plani.

**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-** kemi një mos përputhje tek tabelat, neve na ka ardhur diçka tjetër në KPF ndërsa këtu na ka ardhur, krejt diçka tjetër dhe nuk e di tash gjithë këto parcela nëse i ka komuna e Vushtrrisë, unë me të vërtet jam shumë e lumtur nëse i ka gjithë këto parcela Komuna e Vushtrrisë për t'i dhënë në shfrytëzim. Ndërsa këtu kemi keqkuptime dhe lajthitje të qëllimshme. Ne e kemi miratuar vetëm këtë listë. Në këtë listë janë vetëm dy prona në komunën e Vushtrrisë. Çuditërisht këto dy prona që jepen në shfrytëzim në komunën e Vushtrrisë janë për 99 vite edhe janë vetëm pronat në Stanoc d.m.th në Lumnadh dhe në Stanoc janë për 99 vite, tri prona në Stanoc, një në Lumardh, Smrekonice, Gllavotin dhe

Vushtrri janë për 99 vite. Ndërsa të gjitha pronat tjera që janë në këtë listë në fshatrat si: Studime, Prelluzhë, Ceceli, Bukosh, Gumnishtë të gjitha të tjerat janë për 25 vite. Këtu janë vetëm 51 prona të cilat i keni sjell në kuadër të kësaj liste, 3 prona në Stanoc të Poshtëm, Smrekonicë 2 prona, Gllavatin 2 prona, 1 pronë në Lumadh, 3 në Studime dhe 2 në Vushtrri, por kjo prapë nuk po përputhet me këtë që është dërguar neve në KPF është miratuar në KPF ,është aprovuar një listë tjetër ndërsa një liste tjetër na ka ardhur sot në mbledhjen e kuvendit. A ka mundësi vetëm me i bë të qartë ashtu që me i bë bashkë këto dhe me i sjellë të gjitha në një vend për aprovim. Këtë listën që e ke sjellë drejtor përmes emalit është dashur që ligjërisht të aprovohet para datës 31 dhjetor të vitit paraprak për vitin vijues.

**Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit**-tha se sipas diskutimit të Drejtorit të Pronës, i cili deklaroi e meqë kjo pikë është kthyer nga MAPL-ja atëherë ne mund ta aprovojmë shpejt e shpjet pa përfillur procedurat ligjore, por kjo çështje nuk mund të bëhet kështu. Pastaj këtu e njëjta po shënon kërkesë për rishqyrtimin e vendimit, që tregon se kjo pikë duhet të i nënshtrohet një rivotimi për ta korrigjuar e që rrjedhimisht edhe duhet të jetë në rendin e ditës, përmes votimit të saj, gjë që nuk ndodhu kur u aprovua rendi i ditës. Kjo është dashur të bëhet ose kur është aprovuar rendi i ditës ose si pikë shtesë por që kështu nuk u vepruar dhe konsiderojmë se kjo pikë nuk është futur fare në rendin e ditës.

**Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit**-tha se dallimi mes këtyre pikave mes asaj për rishqyrtimin e vendimit për Komitetin për Komunitete dhe listës së pronave është fakti se kjo e fundit ka kaluar në mbledhjen e KPF-së dhe e kemi proceduar për kuvend si pikë e rregullt. Më tej vlerësoi se pas këtyre gjitha diskutimeve, ka dy rrugë të cilat duhet t'i ndjek për ta përfunduar këtë çështje. Ky material është i harmonizuar me dispozitat e legjisllacionit në fuqi ashtu siç ka kërkuar Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Dhe konsideroj se më që ka kaluar nga komiteti tek kuvendi si pikë e rregullt në rend dite, prandaj nuk ka pasur nevojë të votohet. Andaj mund ta procedojmë në këtë mënyrë dhe mori përsipër që të hartoj një shkresë përcjellëse njoftues lidhur me procedurën e votimit dhe aprovimit të kësaj pike të rendit të ditës.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit**-tha se kjo pikë e rendit të ditë nuk është për tu shqyrtuar sot në këtë mbledhje sepse e njëjta nuk e ka asnjë element që është futur si pikë e rendit të ditës, as nuk është dorëzuar si pikë me rendin e ditës e as që është votuar kjo pikë për të qenë pjesë e rendit të ditës.

**Vlerë Tahiri, anëtare e kuvendit**-tha se sipas propozimeve dhe rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa, pika gjashtë, shqyrtimi i këtij vendimi i datës 30.12.2025 për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënin në shfrytëzim për vitin 2026, KPF-ja ka rekomanduar që kjo pikë të procedohet për kuvend për shqyrtim në mbledhjen e radhës. Duke marrë për bazë rekomandimet e cekur grupi kuvendar i PDK-së mendon se duhet të vazhdohet me shqyrtimin dhe aprovimin e kësaj pike të rendit të ditës sipas vlerësimeve të dhëna nga MAPL-ja.

**Kushtrim Veseli, anëtar i kuvendit**-tha se nëse kjo pikë e rendit të ditës është diskutuar dhe rekomanduar nga Komitetit për Politikë dhe Financa, atëherë mendon se kjo çështje duhet të shqyrtohet dhe aprovohet në këtë mbledhje sepse janë afate ligjore që e kërkojnë një gjë të tillë. Duke marrë për bazë që është interes i komunës që këto prona të publikohen atëherë duhet vazhduar me shqyrtimin dhe aprovimin e kësaj pike të rendit të ditës.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit**-tha se për këtë pikë që jemi duke diskutuar akoma nuk po e dimë a është në rendin e ditës dhe për këtë duhet një konstatim nga kryesuesja e kuvendit se kjo pikë a është në rendin e ditës apo jo. Nëse konstatohet se kjo pikë është në rendin e ditës atëherë vazhdojmë me diskutim dhe në fund me votim.

**Berat Sadiku, anëtar i kuvendit**-tha se në numër rendor 52 Parcela kadastrale P-06003-0 sipërfaqe 30.24 ha, gjendet përballë kalasë, nuk e kemi të qartë cilën pjesë e përfshinë pjesën

tek banesat e kuqe, nuk e dimë se çfarë kemi me dhënë në shfrytëzim aty. Njëjtë është gjendja edhe në fshatin Lumadh, tek zona ekonomike P-435-2 sipërfaqe 2000m<sup>2</sup>, nuk kemi mundur të gjejmë se ku gjendet kjo pronë. Më tej pyeti për parcelat në fshatrat Studime e Poshtme dhe Gumnishtë. Lidhur me këtë ceku se për projekte që janë në mirë të përgjithshme të gjithë do t'i përkrahim pa rezervë dhe pyeti si disa parcela në ZK-Studime e Poshtme me sipërfaqe të përgjithshme prej 112 hektar tokë, çfarë do të bëhet me këto prona dhe cili është interesi që këto prona të jepen në shfrytëzim çfarë përfiton komuna, a do të ketë ndonjë investitor. Ngjashëm është gjendja edhe tek ZK-Gumnishtë ku janë pesë parcela kadastrale me sipërfaqe të përgjithshme prej 155 hektar tokë, për këto duhet të ketë transparencë, cilat do të jenë investimet, a do të ketë ndërtime dhe për çfarë destinimi do të jepen në shfrytëzim këto prona. **Ferit Idrizi, kryetar i komunës**-tha se fillimisht publikim i listës së pronave për dhënien në shfrytëzim është obligim ligjor që derivon nga ligji. Ky proces përmes një vendim të kuvendit ka për qëllim mundësin potenciale për zhvillim ekonomik, ku komuna do të shikoj këto mundësi për ta dhënë në shfrytëzim pronën e saj për nevoja e biznes dhe për ta maksimizuar vlerën e saj dhe për të dhënë mundësi zhvillimit ekonomik të komunës. Ai ceku dhe njoftoj se ky proces është transparent dhe nuk e favorizon askënd sepse i njëjti do t'i nënshtrohet konkurrencës dhe apriori nuk dihet se kusht do të jetë përfitues i pronës për zhvillim ekonomik.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 15 vota “për” 14 vota “kundër” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim aprovet propozimi i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë për publikimin e Listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënien në shfrytëzim për vitin 2026.
2. Pronat e përshkruara në listë mund të jepen në shfrytëzim vetëm pas plotësimit të kushteve ligjore dhe planifikimit në bazë të Planit Zhvillimor Komunal dhe dokumenteve të tjera të planifikimit.
3. Me qëllim të nxitjes të zhvillimit ekonomik, rritjen e vlerës së pronës si dhe shtimin e vendeve të punës në harmoni me planifikimet e komunës, Komuna e Vushtrrisë në të ardhmen planifikon të jep në shfrytëzim pronën e komunës dhe në varësi nga interesi publik të zhvillon procedurat për dhënien në shfrytëzim të pronës së komunës.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista e pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënien në shfrytëzim për vitin 2026.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
11. Rishqyrtimi i vendimit Nr.65277/25 i datës 30.12.2025 për themelimin e Komitetit për Komunitete.

**Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit**-tha se kjo pikë e rendit të ditës është kthyer nga MAPL, sepse sipas dispozitave ligjore nuk është respektuar kuota gjinore dhe po ashtu nga ministria është kërkuar që përbërja shumicë e komitetit për komunitet duhet të jetë nga anëtarë e kuvendit. Më që është kështu bazuar edhe në dispozitat e statutit të komunës së Vushtrrisë, ku përcaktohet se numri i anëtarëve të kuvendit duhet të jetë 9 anëtarë propozoi që të rritet numri i anëtarëve nga 7 anëtarë në 9, sipas statutit të komunës. Prandaj përbërja e komitetit do të jetë dy anëtarë nga PDK-ja, nga një anëtar LVV-ja LDK-ja, Nisma Socialdemokrate një anëtar, kurse katër anëtarë do të jenë nga komunitetet pakicë.



**Vlerë Tahiri, anëtare e kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të PDK-së propozoi për anëtar të Komitetit për Komunitete z. Behar Duraku.

**Xhon Gubetini, anëtar i kuvendit-**propozoi për anëtar të Komitetit për Komunitete z. Mentor Hasani.

Pas propozimeve, kryesuesja e kuvendit i hodhi në votim propozime-emrat për anëtarë të Komitetit për Komunitet Behar Duraku dhe Mentor Hasani morën 17 vota “për” duke bërë anëtarë të Komitetit për Komunitete.

**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të LVV-së propozoi për anëtare të Komitetit për Komunitete znj. Gresa Muli dhe vlerësoi se si grup i dytë në kuvend për nga fuqia e votës i takojnë dy pozita në Komitetin për Komunitete.

Pas votimit znj. Gresa Muli, mori 27 vota “për” duke u bërë anëtare e Komitetit për Komunitete.

**Berat Sadiku, anëtar i kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të LDK-së propozoi për anëtar të Komitetit për Komunitete z. Isak Uka. Ai konsideron se si grup kuvendar iu takojnë dy pozita në Komitetin për Komunitete.

**Gentiana Rama, anëtare e kuvendit-**propozoi për anëtare të Komitetit për Komunitete znj.Fakete Dushi nga radhët e LDK-së.

Pas këtyre propozimeve, kryesuesja e kuvendit i hodhi në votim propozime-emrat për anëtarë të Komitetit për Komunitet z. Isak Uka mori 14 vota “për”, Fakete Dushi mori 15 vota “për” duke bërë anëtarë të Komitetit për Komunitete, nga radhët e LDK-së.

**Kushtrim Veseli, anëtar i kuvendit-** propozoi për anëtare të Komitetit për Komunitete znj.Diellza Pllana nga radhët e Nismës Socialdemokrate.

Pos votimi anëtarja e kuvendit znj. Diellza Pllana nga radhët e Nismës Socialdemokrate, mori 19 vota “për” duke bërë anëtarë të Komitetit për Komunitete.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 22 vota “për” 5 vota “kundër” dhe 2 vota “abstenim” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim themelohet Komiteti për Komunitete, i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, në këtë përbërje:

- 1.1 Behar Duraku, anëtar i Kuvendit të Komunës;
- 1.2 Mentor Hasani, anëtar i Kuvendit të Komunës;
- 1.3 Gresa Muli, anëtare e Kuvendit të Komunës;
- 1.4 Fakete Dushi, anëtare e Kuvendit të Komunës;
- 1.5 Diellza Pllana, anëtare e Kuvendit të Komunës;
- 1.6 Miljan Bojković, përfaqësues i komunitetit serb;
- 1.7 Fahrije Burgazi, përfaqësuese e komunitetit rom;
- 1.8 Adem Hoti, përfaqësues i komunitetit ashkali;
- 1.9 Berat Maloku, përfaqësues i komunitetit turk.

2. Komiteti për Komunitete, detyrat dhe përgjegjësitë do t’i ushtrojë në pajtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ për Procedurën e Themelimit

Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera Komunë, Statutin e komunës, akteve tjera si dhe rregulloren e punës.

3. Mandati i anëtarëve të Komitetit për Komunitete është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të komunës, përveç nëse ky mandat i pushon në rastet e parapara me legjislacionin në fuqi.

4. Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete bëhet në mbledhjen e parë të komitetit, me shumicën e votave të anëtarëve të Komitetit për Komunitete.

5. Kryesuesi i Komitetit për Komunitete zgjedhet nga radhët e komuniteteve joshumicë.

6. Anëtarët e Komitetit për Komunitete, për pjesëmarrje në mbledhje do të kompensohen në bazë të legjislacionit në fuqi në Kosovë.

7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen anëtarët e Komitetit për Komunitete si dhe Zyra për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

8. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Mbledhja u ndërpre në ora 12:15**

**Bastri Duraku**



**Procesmbajtës**

**Melihate Basholli-Latifi**



**Kryesuese e Kuvendit**